



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1165 Prot

Tiranë, më 01.07.2019

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi të brendshëm (me procedurën e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë brenda sistemit doganor)

**DREJTORIVE NË D.P.DOGANAVE  
DEGËVE DOGANORE**

Për publikim: Drejtorisë së Burimeve Mbështetëse

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të pikave 5 dhe 6 të nenit 15 të ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, të Kreut II dhe III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 921 datë 29.12.2014 “Për Personelin e Administratës Doganore”, i ndryshuar, shpall konkurimin e brendshëm për pozicionet:

**Specialist, Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale, Departamenti Operativ Hetimor.**

Kategoria C1, Kategoria e pagës III- b (një vendë)

**Përshkrim përgjithësues për pozicionin:**

Specialisti i Drejtorisë për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale raporton te Drejtori i Drejtorisë dhe sipas kërkesave tek Drejtuesi i Departamentit dhe Drejtori i Përgjithshëm në zbatimin të detyrave të ngarkuara nga aktet ligjore dhe nënligjore që trajtojnë çështjet e pronësisë intelektuale

Kandidatët që konkurojnë për këtë vend pune duhet të plotësojnë këto kritere:

**Kriteret minimale:**

- Të ketë një vlerësim pozitiv apo një certifikatë/vërtetim për një kualifikim të posaçëm profesional, që i përshtatet vendit të ri të punës
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi
- Të përmbushë kriteret e veçanta në shpalljen për konkurim

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar

**Kriteret e veçanta:**

- Të zotërojnë diplomë të nivelit të parë dhe “Master Profesional” ose diploma të barazvlefshme me të sipas legjislacionit të arsimit të lartë në shkencat Ekonomike, Natyrore dhe Juridike.
- Të ketë mbi 1 vitë eksperiencë pune në Administratën Doganore.

Për të qenë pjesëmarrës në konkurrim, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm brenda datës 11.07.2019 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:

1. Kërkesë për marrje pjesë në testim
2. Curriculum Vitae
3. Rekomandim nga eprori direkt.

**Fusha e Njohurive:**

1. Ligji nr102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
2. Ligji nr. 61/2012 datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
3. VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.
4. Ligji nr.9947 datë 07.07.2008 “Për Pronesine Industriale”, i ndryshuar.
5. Ligji nr.9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar.
6. Ligji nr. 8874, datë 29.03.2002 “Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope”.
7. Ligji nr. 9367, datë 07.07.2015 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar
8. Urdhëri nr. 146, datë 07.05.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “ Për miratimin e Rregullores së Brendshme “ Mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Rregullores së Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e Degëve Doganore:
9. Urdhëri nr. 123, datë 09.11.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhërin nr. 90, datë 18.11.2014 “Për miratimin e Kodit të Etikës në Shërbimin Doganor Shqiptar.

Procedura e përzgjedhjes do të bëhet në mbështetje të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e të ulët dhe të mesme drejtuese”, vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar.

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë! Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “[www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al)”.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Arlind Gjokata**

